



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 210/26 Dt. 12.05.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Raporti për Projekt-Planin Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin të të Huajve ne Komunen e Prizrenit-2026-2028

Ky raport është përgatitur në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në Statutin e Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643. Për hartimin e tij janë marrë parasysh edhe dispozitat përkatëse që rregullojnë funksionimin dhe përgjegjësitë e nivelit lokal.

Gjithashtu, raporti mbështetet në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, i cili përcakton standardet për transparencë, llogaridhënie dhe përfshirje të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Në të njëjtën kohë, është respektuar edhe Rregullorja Nr. 01/2025 për Transparencë në Komunën e Prizrenit, e cila synon të forcojë qasjen në dokumente publike dhe të rrisë besimin e qytetarëve ndaj institucioneve komunale.

Me datë 22.04.2026 dhe numër protokolli 01.175/26, kryetari i Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka nënshkruar vendimin për formimin e grupit punues për hartimin e Planit Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Inegrimit të të Huajve ne Komunen e Prizrenit-2026-2028.. Në përbërje të këtij grupi janë: Islam Elshani, kryesues; Asim Imeri, anëtar; Arber Krasniqi, anëtar; Osman Osmani, anëtar; Eleonora Fetollari-Bush, anëtare; Haziz Krasniqi, anëtar.

Konsultimi publik me qytetarët është organizuar nga grupi punues për Projekt-Planin Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimit të të Huajve ne Komunën e Prizrenit-2026-2028 .

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **27:04.2026** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/Njoftimi-Shq-Tur-Bosh.pdf>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=43022>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-me-qytetare-per-planin-komunal-per-riintegrim-te-qendrueshem-te-personave-te-riatdhesuar/>

Me 27.05.2026, njoftimi dhe plani përmes emailit u është dërguar, mediave lokale, OJQ-ve, organizatave, organizatave të studentëve.

Me 07.05.2026, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/u-mbajt-konsultim-publik-me-qytetare-per-projekt-planin-komunal-per-riintegrim-te-qendrueshem-te-personave-te-riatdhesuar/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1GbAPfmyU/>

Projekt-Planin Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integritit të të Huajve ne Komunen e Prizrenit-2026-2028 (në tri gjuhë) u është dorëzuar fizikisht, pjesëmarrësit të cilët ishin në konsultim publik, që të kenë mundësi të njihen më

detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

Gjithashtu për përmbajtjen e planit është përgatitur edhe memorandumi shpjegues.

Me **08.05.2026**, është publikuar procesverbali për mbajtjen e konsultimit publik, procesverbali është i publikuar në këtë vegëz:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/Procesvebali-per-Planin-Komunal-per-Riintegrim-te-Qendrueshem-te-Personave-te-Riatdhesim.pdf>

Dokumenti ka qenë në konsultim publik në uebfaqen zyrtare të komunës dhe platformën e konsultime publike, nga data **27.05.2026** deri me **12.05.2026**, ndërsa komentet janë pranuar deri me datë **12.05.2026**.

Përmes formës elektronike në emailat e zyrtarëve përgjegjës për pranimin e komenteve, kanë pranuar **0** koment në formë elektronike, përmes platformës për konsultimeve publike o komente, kurse gjatë mbajtës së konsultimit publik me qytetarë janë pranuar **2** komente.

Takimi i fundit i grupit punues është mbajtur me **08.05.2026**, ku edhe janë shqyrtuar të gjitha komentet e pranuar.

Tabelori me të dhëna për komente dhe përgjigje në komente:

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Numri i kërkesave
1-Takim i drejtpërdrejtë me qytetarë për Projekt-Planin Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin të të Huajve në Komunën e Prizrenit-2026-2028	07.05.2026 Nga :10:10 Deri: 10:45	F M T 3 15 18	2	Pranuar: 1 Pranuar pjesërisht: 0 Refuzuar: 0 Adresuar: 1
Nr	Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë/ sugjerim	Statusi i kërkesës:	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1	<p>1.Cilat janë obligimet e komunës që dalin nga strategjitë e hartuara në nivel qendror, të cilat përcaktojnë detyra dhe specifika konkrete për institucionet lokale.Ai shtoi se në plan është dashur të përfshihet edhe gjendja aktuale lidhur me kthimin dhe integrimin e personave të riatdhesuar, me qëllim që të paraqitet një pasqyrë më reale e sfidave dhe nevojave ekzistuese.</p> <p>Sa i përket çështjes së shëndetësisë, ai vlerësoi se gjendja institucionale është e mirë dhe institucionet janë të gatshme të ofrojnë shërbime, mirëpo theksoi se përveç kësaj duhet të identifikohen dhe adresohen sfidat kryesore ku kërkohet fokus më i madh institucional.</p> <p>Gjithashtu, ai potencoi rëndësinë e mbështetjes në aspektin gjuhësor për fëmijët e kthyer nga vendet perëndimore, duke theksuar se atyre duhet t'u sigurohen mundësi për të mësuar dhe përvetësuar gjuhën, në mënyrë që të integrohen më lehtë në sistemin arsimor dhe shoqëror.</p>	Bashkim Gashi	Pranuar	<p>nga viti i kaluar Komuna e Prizrenit ka pasur vetëm dy raste të personave të riatdhesuar, duke shtuar se numri i tyre ka rënë dukshëm krahasuar me vitet e mëparshme.</p> <p>Ai bëri të ditur gjithashtu se sa i përket integrimin të të huajve në komunë, aktualisht janë 2-3 familje nga Palestina, ndërsa trajtimi i këtyre rasteve menaxhohet kryesisht nga ministria përkatëse.</p> <p>-Lidhur me planifikimet për të ardhmen, ai tha se nuk dihet saktësisht se sa familje do të ketë që do të riatdhesohen në periudhën në vijim. Sipas tij, deri më tani kanë qenë gjithsej shtatë (7) familje të akomoduar, ndërsa aktualisht janë gjashtë (6), pasi një person ka ndërruar jetë si pasojë e një sëmundjeje kronike</p>
2	1.U interesua për çështjen e riatdhesimit, veçanërisht për rastet e personave që janë kthyer dhe që kanë probleme shëndetësore. Ai parashtrroi pyetjen nëse kthimi i tyre bëhet me dëshirën e tyre apo në	Simon Veseli	Adresuar	Cështja e personave të riatdhesuar bazohet në marrëveshjet për kthim, duke përmendur marrëveshjen e vitit 2013 për kthimin e personave. Ai theksoi se personat që nuk posedojnë dokumentacion të rregullt ose leje

forma të tjera të procedurave të riatdhesimit dhe kush janë ata që qendrojnë në mesin tonë.
Gjithashtu, ai ngriti disa shqetësime lidhur me disa raste të personave të ardhur nga Palestina, duke përmendur se sipas perceptimit të tij disa prej tyre janë në gjendje të mirë financiare, ndërkohë dhe kërkojnë neper rrugë, ndërsa njëkohësisht ka qytetarë nga Kosova që përballen me mungesë strehimi dhe vështirësi ekonomike, derisa në po mirremi me te huaj. Ku nuk e dim as qëllimin e tyre, cila është arsyeja që janë në mesin tonë, kemi dhe imazh të keq për qytetin tonë.

qëndrimi nuk mund të vazhdojnë qëndrimin në shtetet përkatëse. Sa i përket çështjes së personave të huaj, ai theksoi se këto raste trajtohen kryesisht nga ministria përkatëse, duke shtuar se në takim është i pranishëm edhe zyrtari kompetent, i cili mund të japë përgjigje më të detajuara lidhur me pyetjet dhe shqetësimet e ngritura nga pjesëmarrësit.

Komunën e Prizrenit trajton raste të personave të huaj që kanë marrë leje qëndrimi. Ai sqaroi se vendimet për akomodim merren nga ministria përkatëse, ndërsa në trajtimin e këtyre rasteve ekziston bashkëpunim me ZKKK-në dhe institucionet relevante.

Sipas tij, shumica e familjeve të riatdhesuar mbështeten përmes pagesës së qirasë, energjisë elektrike, ushqimit dhe nevojave të tjera bazike, me qëllim të sigurimit të kushteve minimale për jetesë.

Sa i përket personave që kërkojnë ndihmë nëpër rrugë, ai theksoi se nuk preferon të japë komente lidhur me këtë çështje, duke shtuar se trajtimi i rasteve të tilla i përket kompetencave të Policia e Kosovës.

Shkurtesat:

F-Femra

M-Meshkuj

T-Totali

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit,
2. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik,
3. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik

Raporti është përgatitur nga:

Haziz Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

01 Nr. 208/26 Dt. 08.05.2026

**Procesverbali nga mbajtja e konsultimit publik me qytetarë për Projekt-
Planin Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar
dhe Integrimin të të Huajve ne Komunen e Prizrenit-2026-2028**

Me datë 22.04.2026 dhe numër protokolli 01.175/26, kryetari i Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka nënshkruar vendimin për formimin e grupit punues për hartimin e Projekt-Planin Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin të të Huajve në Komunen e Prizrenit-2026-2028. Në përbërje të këtij grupi janë: Islam Elshani, kryesues; Asim Imeri, anëtar; Arber Krasniqi, anëtar; Osman Osmani, anëtar; Eleonora Fetollari-Bush, anëtare; Haziz Krasniqi, anëtar.

Gjatë këtyre takimeve, janë trajtuar në mënyrë të detajuar sfidat kryesore me të cilat përballen personat e riatdhesuar, duke përfshirë qasjen në shërbime sociale, arsim, punësim dhe strehim. Anëtarët e grupit punues kanë analizuar legjislacionin në fuqi, praktikat më të mira dhe nevojat specifike të kësaj kategorie, me qëllim hartimin e masave konkrete dhe të zbatueshme në nivel lokal.

Në këtë proces janë përfshirë edhe palë të ndryshme të interesit, përfshirë përfaqësues institucionalë, organizata të shoqërisë civile dhe partnerë ndërkombëtarë, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar. Si rezultat i këtyre diskutimeve dhe kontributeve, dokumenti synon të ofrojë një kornizë të qartë veprimi për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në komunë.

Njoftimet për qytetarë për organizimin e konsultimit publik janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **27:04.2026** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/Njoftimi-Shq-Tur-Bosh.pdf>

Në facebook:

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=43022>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-me-qytetare-per-planin-komunal-per-riintegrim-te-qendrueshem-te-personave-te-riatdhesuar/>

Konsultimi është mbajtur në sallën e kuvendit komunal (Shtëpia e Bardh) dhe ka filluar në orën 10:10

Gjithashtu pjesëmarrës në konsultim publik edhe grupet e tjera të interesit përkatësisht përfaqësues të OJQ-ve si dhe mediet.

Hapja e konsultimit publik është bërë nga Haziz Krasniqi, zyrtar i Lartë për Informim dhe zyrtar përgjegjës për konsultime publike duke thënë se jemi mbledhur sot në këtë konsultim publik për shqyrtimin e Projekt-Planit Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integritit të të Huajve ne Komunen e Prizrenit-2026-2028. Për detajet dhe përmbajtjen e këtij plani, fjalën do ta marrë z. Islam Elshani.

Ju njoftoj se organizimi i këtij konsultimi publik është bërë në përputhje me afatet ligjore. Ky dokument do të vazhdojë të jetë në konsultim publik deri më 12.05.2026. Gjithashtu, të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të kontribuojnë në këtë dokument mund t'i dërgojnë komentet apo sugjerimet e tyre deri më 12.05.2026 në adresat elektronike: Islam.Elshani@rks-gov.net , Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net .

Planit u është dërguar me kohë edhe OJQ-ve, bizneseve, drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave, kryetarëve të lagjeve dhe fshatrave, ekspertëve të fushave të ndryshme, si dhe institucioneve shëndetësore.

Më pas, fjalën e mori **Z. Islam Elshani**, theksoi gjithashtu se institucionet komunale kanë qenë pranë familjeve që kanë pasur probleme shëndetësore, duke ofruar mbështetje sipas nevojave të tyre. Ai shtoi se një vëmendje e veçantë u është kushtuar edhe familjeve që kanë qëndruar në vendet perëndimore, veçanërisht fëmijëve që kanë vijuar mësimin atje dhe që pas kthimit janë ndihmuar në procesin e regjistrimit dhe integritit në shkollat e Komunës së Prizrenit.

Po ashtu, bëri të ditur se ekzistojnë dy skema pra ajo emergjente, dhe skema e qendrueshmerise për mbështetjen e personave të riatdhesuar:

1. **Skema e gjendjes emergjente** – për një periudhë tre (3) mujore, ku familjeve në nevojë u ofrohet mbështetje me ushqim dhe akomodim.
2. **Skema e qëndrueshmërisë** – nga kjo skemë përfitojnë familjet që posedojnë prona, por që ende nuk i kanë të rregulluara dokumentacionet përkatëse, me mundësi që në të ardhmen t'u ndërtohen ose renovohen shtëpitë në bazë të kushteve dhe procedurave të parapara.

-Më pas, fjalën e mori **Bashkim Gashi**, i cili theksoi se obligimet për komunën burojnë nga strategjitë e hartuara në nivel qendror, të cilat përcaktojnë detyra dhe specifika konkrete për institucionet lokale. Ai shtoi se në plan është dashur të përfshihet edhe gjendja aktuale lidhur me kthimin dhe integrimin e personave të riatdhesuar, me qëllim që të paraqitet një pasqyrë më reale e sfidave dhe nevojave ekzistuese.

Sa i përket çështjes së shëndetësisë, ai vlerësoi se gjendja institucionale është e mirë dhe institucionet janë të gatshme të ofrojnë shërbime, mirëpo theksoi se përveç kësaj duhet të identifikohen dhe adresohen sfidat kryesore ku kërkohet fokus më i madh institucional.

Gjithashtu, ai potencoi rëndësinë e mbështetjes në aspektin gjuhësor për fëmijët e kthyer nga vendet perëndimore, duke theksuar se atyre duhet t'u sigurohen mundësi për të mësuar dhe përvetësuar gjuhën, në mënyrë që të integrohen më lehtë në sistemin arsimor dhe shoqëror.

-Në përgjigje të diskutimeve, **Islam Elshani** theksoi se nga viti i kaluar Komuna e Prizrenit ka pasur vetëm dy raste të personave të riatdhesuar, duke shtuar se numri i tyre ka rënë dukshëm krahasuar me vitet e mëparshme.

Ai bëri të ditur gjithashtu se sa i përket integrimin të të huajve në komunë, aktualisht janë 2-3 familje nga Palestina, ndërsa trajtimi i këtyre rasteve menaxhohet kryesisht nga ministria përkatëse.

-Lidhur me planifikimet për të ardhmen, ai tha se nuk dihet saktësisht se sa familje do të ketë që do të riatdeshohen në periudhën në vijim. Sipas tij, deri më tani kanë qenë gjithsej shtatë (7) familje të akomoduar, ndërsa aktualisht janë gjashtë (6), pasi një person ka ndërruar jetë si pasojë e një sëmundjeje kronike

-Më pas, fjalën e mori **Simon Veseli**, i cili shprehu interesimin e tij lidhur me çështjen e riatdhesimit, veçanërisht për rastet e personave që janë kthyer dhe që kanë probleme shëndetësore. Ai parashtrroi pyetjen nëse kthimi i tyre bëhet me dëshirën e tyre apo në forma të tjera të procedurave të riatdhesimit dhe kush janë ata që qendrojnë në mesin ton.

Gjithashtu, ai ngriti disa shqetësime lidhur me disa raste të personave të ardhur nga Palestina, duke përmendur se sipas perceptimit të tij disa prej tyre janë në gjendje të mirë financiare, ndërkohë dhe kërkojnë neper rrugë, ndërsa njëkohësisht ka qytetarë nga Kosova që përballen me mungesë strehimi dhe vështirësi ekonomike, derisa ne po mirremi me të huaj. Ku nuk e dim as qëllimin e tyre, cila është arsyeja që janë në mesin tonë, kemi dhe imazh të keq për qytetin tonë.

-Në përgjigje të pyetjeve dhe shqetësimeve të ngritura, **Islam Elshani** sqaroi se çështja e personave të riatdhesuar bazohet në marrëveshjet për kthim, duke përmendur marrëveshjen e vitit 2013 për kthimin e personave. Ai theksoi se personat që nuk posedojnë dokumentacion të rregullt ose leje qëndrimi nuk mund të vazhdojnë qëndrimin në shtetet përkatëse.

Sa i përket çështjes së personave të huaj, ai theksoi se këto raste trajtohen kryesisht nga ministria përkatëse, duke shtuar se në takim është i pranishëm edhe zyrtari kompetent, i cili mund të japë përgjigje më të detajuara lidhur me pyetjet dhe shqetësimet e ngritura nga pjesëmarrësit.

-Më pas, fjalën e mori **Berat Gashi**, i cili theksoi se zyrat në Komunën e Prizrenit trajtojnë raste të personave të huaj që kanë marrë leje qëndrimi. Ai sqaroi se vendimet për akomodim merren nga ministria përkatëse, ndërsa në trajtimin e këtyre rasteve ekziston bashkëpunim me ZKKK-në dhe institucionet relevante.

Sipas tij, shumica e familjeve të riatdhesuar mbështeten përmes pagesës së qirasë, energjisë elektrike, ushqimit dhe nevojave të tjera bazike, me qëllim të sigurimit të kushteve minimale për jetesë.

Sa i përket personave që kërkojnë ndihmë nëpër rrugë, ai theksoi se nuk preferon të japë komente lidhur me këtë çështje, duke shtuar se trajtimi i rasteve të tilla i përket kompetencave të Policisë së Kosovës.

Të gjitha komentet dhe propozimet e paraqitura do të shqyrtohen dhe do të merren parasysh në procesin e finalizimit të planit.

Konsultimi ka përfunduar në orën 10:45.

Me 07.05.2026, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/u-mbajt-konsultim-publik-me-qytetare-per-projekt-planin-komunal-per-riintegrim-te-qendrueshem-te-personave-te-riatdhesuar/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1GbAPfmyU/>

Procesmbajtës:

Senada Etemi

Zyrtare për të Drejtat dhe Integreimin e Komuniteteve

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Haziz Krasniqi

Zyrtar i Lartë për Informim

Zyrtar për Konsultime Publike





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Председник Општине
Belediye Başkanı



01 Nr. 175/26 Dt. 22.04.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Grupit Punues

1. Formohet dhe emërohet Grupi Punues për hartimin e Projekt Planit Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Prizrenit 2026-2028. Anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:

- 1.1. Islam Elshani.....kryesues,
- 1.2. Asim Imeri,anëtar,
- 1.3. Arbër Krasniqi,.....anëtar,
- 1.4. Osman Osmani,.....anëtar,
- 1.5. Eleonora Fetollar Bush,.....anëtare,
- 1.6. Haziz Krasniqi,anëtar.

2. Detyrat e Grupit Punues të emëruar si në pikën 1 të këtij Vendimi është që në afat sa më të shkurtër kohor të hartoj Projekt Planin Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Prizrenit 2026-2028, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe pas hartimit të draftit përkatës, ti procedohet organeve kompetente për shqyrtim dhe miratim.
3. Obligohet Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Grupi Punues për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
 - Zyrës për Komunitete dhe Kthim,
 - Grupit Punues,
 - Arkivës së Kryetarit.



NJOFTIM PUBLIK

Komuna e Prizrenit fton qytetarët në konsultim publik për Projekt-Planin Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Inegrimit të të Huajve ne Komunen e Prizrenit-2026-2028



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

Data : 07.05.2026

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit Komunal (Shtëpia e Bardhë)

Të dashur qytetarë/e,

Komuna e Prizrenit përmes grupit punues për hartimin e Projekt-Planit Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Inegrimit të të Huajve ne Komunen e Prizrenit-2026-2028, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Prizrenit. Nr. 01/011-5643, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna dhe Rregulloren 01/2025 për Transparencë në Komunën e Prizrenit, lëshon këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Projekt-Planin Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Inegrimit të të Huajve ne Komunen e Prizrenit-2026-2028

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga **27.04.2026** deri me datën: **12.05.2026** ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me **07.05.2026**, në sallën e Kuvendit Komunal (Shtëpia e Bardhë), me fillim në ora **10:00**.

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri me datën **12.05.2026** në ora **10:00**, në emailat e zyrtarëve: Islam.Elshani@rks-gov.net, Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net, si dhe ne formë fizike në këtë adresë: Rruga Adem Jashari Nr 275 Prizren 20000 (Shtëpia e Bardhë).

Për më shumë detaje Projekt-Planin Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Inegrimit të të Huajve ne Komunen e Prizrenit-2026-2028, mund t'i vizitoni vegëzat e mëposhtme:

Uebfaqen zyrtare në rubrikën planet në konsultim publik: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/?tax=planet-ne-konsultim-publik>

Platformën për Konsultime Publike: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/>

Facebook: <https://www.facebook.com/kkprizren>

Memorandumi shpjegues për rregulloren: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/?tax=memorandume-shpjeguse>

Ymer Berisha

Udhëheqës i Njesisë për Komunikim me Publikun




JAVNO OBAVEŠTENJE

Opština Prizren poziva građane na javnoj konsultaciji o Opštinskom Projekt Pravilniku za Održivu Reintegraciju Vraćenih Osoba

Dana: 07.05.2026

Mesto: Sala za sednice Skupštine Opštine (Bela Kuća)

Vreme: 10:00



Poštovani građani,

Opština Prizren je preko radne grupe za izradu Opštinskog Plana za Postojanu Reintegraciju Vraćenih Osoba, na osnovu Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu Samoupravu, Statut opštine Prizren. br. 01/011-5643, Administrativnog uputstva (MALS) br. 04/2023 za Otvorenu Administraciju u Opštinama i Pravilnika 01/2025 za Transparentnost u Opštini Prizren, daje ovo:

JAVNO OBAVEŠTENJE

U vezi sa organizovanjem javnih konsultacija sa građanima za Opštinski Projekt Plan za Postojanu Reintegraciju Vraćenih Osoba

Ovaj dokument će biti na javnoj konsultaciji od **27.04.2026** do datuma: **12.05.2026** dok će se javna konsultacija sa građanima održati **07.05.2026**, u sali za sednice Skupštine opštine (Bela kuća) sa početkom od **10:00 h**.

Vaše komentare i sugestije možete slati do datuma **12.05.2026** u **10:00**, na e mail službenika: Islam.Elshani@rks-gov.net, Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net i Haziz.Krasniqi@rks-gov.net, kao i u fizičkoj formi na ovoj adresi: ulica Adem Jashari br. 275 Prizren, 20000 (Bela Kuća).

Za više detalja o Projekt Plan za Postojanu Reintegraciju Vraćenih Osoba, možete posetiti linkove:

Službeni portal u rubrici planovi na javnoj konsultaciji: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/?tax=planet-ne-konsultim-publik>

Platforma za javne konsultacije: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/>

Facebook: <https://www.facebook.com/kkprizren>


Memorandum objašnjenja za Pravilnik: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/?tax=memorandume-shpjeguse>

REPUBLIKA E KOSOVË * REPUBLIC OF KOSOVO
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 179/26 Dt. 27.04.2026

Ymer Berisha
Rukovodilac Jedinice za Odnose sa Javnošću

re: [Signature]



KAMU BİLDİRİSİ

Geri Gönderilen Kişilerin Sürdürülebilir Yeniden Entegrasyonu için Belediye Taslak Planı ile ilgili kamu istişarenin düzenleneceği tüm Prizren Belediye sakinlerini davet etmektedir.

Tarih : 07.05.2026

Yer: Belediye Meclis toplantı salonu (Beyaz Ev)

Saat : 10:00

REPUBLIKA E KOSOVES * REPUBLIK
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 179/26 Dt. 27.04.2026

Sevgili vatandaşlar,

03/L-040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'un, 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü'nün ve Prizren Belediyesinde Şeffaflıkla ilgili 01/2025 sayılı Yönetmeliği ile Belediyelerde Açık Yönetim için 04/2023 sayılı İdari Talimat (YYİB) gereğince Geri Gönderilen Kişilerin Sürdürülebilir Yeniden Entegrasyonu için Belediye Planın tasarlanması için çalışma grubu aracılığıyla işbu duyuruyu sunmaktadır:

Geri Gönderilen Kişilerin Sürdürülebilir Yeniden Entegrasyonu için Belediye Taslak Planı ile ilgili kamu istişarenin düzenlenmesi için
KAMU BİLDİRİSİ

Söz konusu belge **27.04.2026 - 12.05.2026** tarihine kadar kamu istişarede olacaktır. Halkla kamu istişare ise **07.05.2026** tarihinde Belediye icra binasının üçüncü katında – Belediye Yönetim salonunda saat 10:00 da başlamak üzere düzenlenecektir.

Yorum ve önerilerinizi **12.05.2026** tarihinde saat **10:00** kadar: Islam.Elshani@rks-gov.net , Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net ve Haziz.Krasniqi@rks-gov.net yetkililerin e – posta adreslerine iletebilir ya da Adem Jashari caddesi No. 275 Prizren 20000 (Beyaz Ev) adresine teslim edebilirsiniz.

Geri Gönderilen Kişilerin Sürdürülebilir Yeniden Entegrasyonu için Belediye Taslak Planı Taslağı ile ilgili daha fazla bilgi için aşağıdaki siteleri ziyaret edebilirsiniz:

Resmi web sitenin kamu istişare yönetmelikler kısmında: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/?tax=planet-ne-konsultim-publik>

Kamu İstişare Platformu: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/>

Facebook: <https://www.facebook.com/kkprizren>

Yönetmelik için açıklayıcı iyi niyet sözleşmesi: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/?tax=memorandume-shpjeguse>

Ymer Berisha
Halkla İletişim Birim Yöneticisi

per:



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **anëtarëve** pjesëmarrës në konsultimin publik për: Projekt Planit Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar

Data e mbajtjes së konsultimit: 24. 04.2026.

Nr.	Emri/Mbiemri	Gjinia	Nr.Tel	Email	Nënshkrimi
1	OSMAN OSMANI	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
2	ASIM IMOÇI	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
3	ISLAM ELSHANI	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
4	Arben Kosoviqi	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
5	HAZIZ KRASHIÇI	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
6					
7					
8					
9					
10					



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **qytetarëve** pjesëmarrës në konsultimin publik për: Projekt Planit Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riadhesuar

Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.

Data e mbajtjes së konsultimit: 07.05.2026.

Nr.	Emri/Mbiemri	Gjinia	Nr.Tel	Email	Nënshkrimi
1	Blerimu Gashi	M	[REDACTED]	[REDACTED]	Blerimu Gashi
2	Rexhodi ATAZAI	M	[REDACTED]	[REDACTED]	Rexhodi ATAZAI
3	Jehona Selimi	F	[REDACTED]	[REDACTED]	Jehona Selimi
4	Anisa Krasniqi	M	[REDACTED]	[REDACTED]	Anisa Krasniqi
5	Simon Vokaj	M	[REDACTED]	[REDACTED]	Simon Vokaj
6	BEERAT GASHI	M	[REDACTED]	[REDACTED]	BEERAT GASHI
7	ISMET RUSTEMAT	M	[REDACTED]	[REDACTED]	ISMET RUSTEMAT
8	Benjamin Mendeskaj	M	[REDACTED]	[REDACTED]	Benjamin Mendeskaj
9	Shkëlzen Gjoni	M	[REDACTED]	[REDACTED]	Shkëlzen Gjoni
10	Haris Haxhiu	M	[REDACTED]	[REDACTED]	Haris Haxhiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **qytetarëve** pjesëmarrës në konsultimin publik për: Projekt Planit Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar

Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.

Data e mbajtjes së konsultimit: 07.05.2026.

Nr.	Emri/Mbiemri	Gjinia	Nr.Tel	Email	Nënshkrimi
1	JUSTAFA PALLUSHI	M	[REDACTED]		[Signature]
2	Agon Ukimercep	M	[REDACTED]		[Signature]
3	Rama Shimoj	M	[REDACTED]		[Signature]
4	Leht Soliqi	M	[REDACTED]		[Signature]
5	HABIE KRASHI	M			[Signature]
6	Besarta Gashi	F			[Signature]
7	Beirne Jhoti	F			[Signature]
8	AVDI KASTVATI	M			[Signature]
9					
10					



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **anëtarëve** të komisionit për hartimin e Projekt Planit Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar

Nr.	Emri/Mbiemri	Gjinia	Nr.Tel	Email	Nënshkrimi
1	Islamy Elshani	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
2	Fatmir Mehmeti	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
3	OSMAN OSMANI	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
4	ASIM IMEÇI	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
5	Arben Krasniqi	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
6	Eleonora Fetollari Buz	F	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
7	Horat Jhoriqi	M	[REDACTED]	[REDACTED]	[Signature]
8					
9					
10					